



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:092029  
Datë: 22.12.2023  
Numri i dokumentit: 05114392

**APS.nr.16/2023**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – DEPARTAMENTI SPECIAL**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Kreshnik Radoniqi – kryetar, Vaton Durguti dhe Bashkim Hyseni – anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Endrit Ajeti, në lëndën penale ndaj të akuzuarve A.A, F.K, E.H dhe A.B, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Kryerja e veprës penale terroriste nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 135 par.1 lidhur me par.1.7 të KPRK-së lidhur me nenin 31 të KPK-së, duke vendosur lidhur më ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.42/2016 të datës 09 Mars 2023, të ushtuar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti Special PKR.nr.70/18 të datës 15.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 31.10.2023, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special PKR.nr.70/18 i datës 15.02.2023, **VËRTETOHET**.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special me aktgjykimin PKR.nr.70/18 të datës 15.02.2023 të akuzuarit A.A , F.K, E.H dhe A.B , konform nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, i ka liruar nga akuzua për veprën penale në bashkëkryerje Kryerja e veprës penale terroriste nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 135 par.1 lidhur me par.1.7 të KPRK-së lidhur me nenin 31 të KPK-së, për shkak të mungesës së provave. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

### Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal me propozim që Gjykata e Apelit ta anuloj aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim.

Përgjigje në ankesë të Prokurorisë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit E.H -av.Emrush Kastrati, me propozim që të refuzohet ankesa e prokurorit të shtetit ndërsa të vërteton aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, të goditur me ankesë.

Përgjigje në ankesë të Prokurorisë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarës A.B -av.Ali Beka, me propozim që të refuzohet ankesa e prokurorit të shtetit si e pabazuar dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti-Special, PKR.nr.70/18 të dt.27.12.2022, ta vërtetoj.

Prokurori i Apelit me parashtresën PPA/I.nr.172/2023 të datës 22.03.2023 dhe 31.10.2023, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje ndërsa të refuzohen si të pabazuara përgjigjet në ankesë të parashtruara nga mbrojtësit e të akuzuarve E.H -av.Emrush Kastrati dhe A.B -av.Ali Beka.

Gjykata e Apelit konform nenit 390 të KPP-së, për datë 31.10.2023 ka caktua seancën e kolegjit në të cilën nuk kanë prezantuar të akuzuarit me mbrojtësit e tyre, A.A -av.Ramzi Krasniqi, F.K-av.Florent Latifaj, E.H -av.Emrush Kastrati dhe A.B -av.Ali Beka, të cilët mbetën pranë përgjigjeve në ankesë dhe e kundërshtuan në tërësi ankesën e Prokurorisë, ndërsa nuk prezantoi

askush nga Prokuroria e Apelit, edhe pse të njoftuar me rregull për ditën dhe kohën e mbajtje së seancës.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorisë, së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se: **Ankesa nuk është e bazuar.**

### **Pretendimet ankimore**

Në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës theksohet se gjykata e shkallës së parë ka bë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse arsyetimi i aktgjykimit është në kundërshtim me të. Në të vërtetë në arsyetimin e aktgjykimit janë përshkruar dëshmitë e dëshmitarëve por të njëjtat nuk janë analizuar fare jo vetëm individualisht secila prej tyre por as lidhja logjike mes tyre në njërën anë e në anën tjetër edhe me disa provat materiale. Arsyetimi i aktgjykimit është në kundërshtim me provat e administruara. Në të vërtetë nga dëshmia e dëshmitarit N.M rezulton që telefonin e markës “Samsung” ia ka shitur të pandehurës A.B , citon;” kur unë ja kam shitur telefonin e kam njohur se ka qenë rast i freskët dhe 100% është e akuzua në sallë A.B ”. Gjykata e shkallës së parë, këtë provë e konsideron si të vetme dhe të pambështetur edhe në provat tjera prandaj nuk ia fal besimin e plotë. Më tej shton se konstatimi se emaili i dërguar me datë 05.08.2016, nuk ka mund të dërgohet nga të pandehurit A.B dhe F.K sepse ky email i krijuar një javë më herët është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm. Telefoni i blerë ishte telefon i vjetër dhe emailt e hapura kanë qenë të përdorshme. Më tej shton se nga dëshmia e dëshmitarit H.R , lidhur me motoçikletën e shitur nga ana e tij rezulton qartë se bëhet fjalë për të njëjtën mjet të djegur pas kryerjes së veprës penale. Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje juridiko-penale, dëshmitarët e dëgjuar në gjykatë kanë pasur dozë pasigurie dhe për shkak të kujtesës së tyre prandaj gjykata është dashur ti ketë parasysh dëshmitë e tyre të dhënë në fazat e hershme të kësaj procedure kur kujtesa e tyre ishte më e qartë dhe më e freskët. Në anën tjetër vet i akuzuari A.A gjatë seancës për caktimin e masës së paraburgimit është deklaruar “e kundërshtoj kërkesën e PSRK për caktimin e paraburgimit, nuk e kam kryer veprën penale, e pranon se një motor me ngjyrë të kuqe nuk e di se çfarë marke e ka ble nga një person të cilin nuk e njoh me atë rast me mua ka qenë tani i ndjeri A.D dhe E.H ”.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur të vërtetoj gjendjen faktike sepse provat e shumta të administruara janë vlerësuar në mënyrë të shkoqur nga njëra tjetra përkundër faktit që në rastin konkret provat materiale dhe dëshmitë e dëshmitarëve kanë ndërlidhje të qartë me shumë prova rrethore e të cilat gjykata as që i ka përmendur. Në të vërtetë, lidhshmëria logjike e provave

qartë vërteton se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në aktakuzë. Gjykata e shkallës së parë, duke i liruar të akuzuarit nga vepra penale sipas aktakuzës nuk ka arritur të vërtetoj drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike prandaj si pasojë e kësaj është shkel edhe ligji penal, andaj për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

### **Përgjigje në ankesë**

Mbrojtësi i të akuzuarit E.H -av.Emrush Kastrati, konsideron se aktgjykimi i ankimuar është i kuptueshëm, nuk është kundërthënës siç pretendon ankesa, dhe i bazuar në provat që janë administruar dhe të njëjtat janë arsyetuar në mënyrë bindëse, çka konsideron se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pavarësisht se në ankesë nuk i ka potencuar se cilat janë ato shkeljet procedurale, duke shtuar më tej se vërtetimi i gjendjes faktike është bërë në mënyrë të plotë dhe të drejtë, prandaj gjykata ka ardhur në përfundim se nuk ka prova për ti shpallur fajtor të akuzuarit, për çka edhe me të drejtë ka marrë aktgjykimi lirues, ndërsa se është shkelur ligji penale prokurori i shtetit nuk potencon as të vetmin fakt se si qenka shkelur ligji penal, andaj për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarës A.B -av.Ali Beka, konsideron se vet paqartësitë e theksuara në ankesë janë tregues i mjaftueshëm se edhe aktakuza ka qenë e padrejtë, konfuzë dhe pa mbështetje në prova, ndërsa gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar nga prokuroria, plotësisht dhe në mënyrë të saktë i ka vërtetuar të gjitha faktet vendimtare dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar kodin e procedurës penale, dhe ka dhënë arsye e qarta për lirimin e të pandehurve nga akuza. Gjitha ashtu janë të paqëndrueshme pretendimet e prokurorisë për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal sepse nuk ka asnjë dileme apo dyshim se gjykata e shkallës së parë drejt dhe plotësisht e ka vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje penale, andaj për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

### **Gjetjet e Gjykatës së Apelit**

Gjykata e Apelit, pasi analizoi aktgjykimin e ankimuar së bashku me shkresat e lëndës dhe duke vlerësuar pretendimet ankimore të Prokurorisë Speciale, e duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, gjeti se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPPRK-së, nga fakti se dispozitivi është i qartë dhe në përputhje me arsyetimin në të cilin janë paraqitur arsyet e plota dhe të qarta për fakteve vendimtare së bashku me arsyet me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike të kësaj çështje penale

dhe se nuk përmban asnjë shkelje tjetër e cila kishte për të kushtëzuar anulimin e detyrueshëm të aktgjykimit të ankimuar.

Aktgjykimi i ankimuar përmban arsyet e duhura mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje penale andaj, kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e prokurorit të shtetit në ankesë, se në arsyetimin e aktgjykimit janë përshkruar dëshmitë e dëshmitarëve por të njëjtat nuk janë analizuar fare jo vetëm individualisht secila prej tyre por as lidhja logjike mes tyre në njërën anë e në anën tjetër edhe me disa provat materiale dhe se arsyetimi është në kundërshtim me provat e administruara, i gjen si të pabazuara ngase gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësimin e të gjitha provave të procedura në shqyrtimin gjyqësor dhe pas analizimit dhe vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 360 të KPPRK-së, ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive dhe ligjore i pranon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e Apelit vëren se në ankesë prokuroria lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale i referohet dëshmimeve të dëshmitarëve, duke i cituar pjesë të tyre, por që në fakt nga teksti i pretendimit rrjedh se këto kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes së fakteve andaj, gjykata do ti vlerësoj në vijim të arsyetimit për këtë bazë të pretendimeve.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin e prokurorisë se gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur të vërtetoj gjendjen faktike, sepse provat e shumta të administruara janë vlerësuar në mënyrë të shkoqur nga njëra tjetra përkundër faktit që në rastin konkret provat materiale dhe dëshmitë e dëshmitarëve kanë ndërlidhje të qartë me shumë prova rrethore e të cilat gjykata as që i ka përmendur, në të vërtetë lidhshmëria logjike e provave qartë vërteton se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në aktakuzë. Kjo për faktin se, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar përkitazi me këto pretendimet e ngritura dhe të apostrofuara nga prokuroria, ka dhënë arsyet e qarta dhe të mjaftueshme nga të cilat ka ardhur në përfundim të drejtë se nga këto prova të administruara në shqyrtim gjyqësor nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit janë bashkëkryerësit e veprës penale për të cilën janë akuzuar me aktakuzën e prokurorisë.

Për sa i përket pretendimit të prokurorisë si në ankesë, se në të vërtetë nga dëshmia e dëshmitarit N.M rezulton që telefonin e markës “Samsung” ia ka shitur të pandehurës A.B , *citon;*” kur unë ja kam shitur telefonin e kam njohur se ka qenë rast i freskët dhe 100% është e akuzua në sallë A.B ” dhe gjykata e shkallës së parë këtë provë e konsideron si të vetme dhe të pambështetur edhe në provat tjera, prandaj nuk ia fal besimin e plotë, duke shtuar më tej se konstatimi se

emaili i dërguar me datë 05.08.2016, nuk ka mund të dërgohet nga të pandehurit A.B dhe F.K sepse ky email i krijuar një javë më herët, është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm, se telefoni i blerë ishte telefon i vjetër dhe emaillet e hapura kanë qenë të përdorshme, dhe se nga dëshmia e dëshmitarit, H.R , lidhur me motoçikletën e shitur nga ana e tij rezulton qartë se bëhet fjalë për të njëjtën mjet të djegur pas kryerjes së veprës penale, dhe se duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje juridiko-penale, dëshmitarët e dëgjuar në gjykatë kanë pasur dozë pasigurie dhe për shkak të kujtesës së tyre, prandaj gjykata është dashur ti ketë parasysh dëshmitë e tyre të dhënë në fazat e hershme të kësaj procedure kur kujtesa e tyre ishte më e qartë dhe më e freskët, ndërsa në anën tjetër vet i akuzuari A.A gjatë seancës për caktimin e masës së paraburgimit është deklaruar “e kundërshtoj kërkesën e PSRK për caktimin e paraburgimit, nuk e kam kryer veprën penale, e pranon se një motor me ngjyrë të kuqe nuk e di se çfarë marke e ka ble nga një person të cilin nuk e njoh me atë rast me mua ka qenë tani i ndjeri A.D dhe E.H ”, sipas vlerësimit të këtij kolegji penale këto pretendimet janë të pabazuara ngase të gjitha këto prova, të pretenduara si më lartë, gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar një nga një dhe në ndërlidhje me njëra tjetrën dhe përkitazi me të njëjtat ka dhënë arsyet e qarta dhe konkrete në raport me faktet të vërtetuara apo të pavërtetuara të kësaj çështje penale, e nga të cilat ka ardhur në përfundim se me provat e administura në shqyrtim gjyqësor nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit, në bashkëkryerje, të kenë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar, për të cilën përfundim pajtohet edhe kjo Gjykatë si të drejtë dhe ligjor, ngase si rrjedh edhe nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar nga provat materiale të gjetura në vendin e ngjarjes të cilët pas ekzaminimeve nga institutet përkatëse nuk kanë vërtetuar për të ndërlidhur të akuzuarit me rastin për të cilin akuzohen sipas aktakuzës për kryerjen e veprës penale terroriste nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 135 par.1 nënpar.1.7 e lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Pretendimi ankimor i prokurorisë se nga dëshmia e dëshmitarit, N.M , rezulton që telefonin e markës “Samsung” ia ka shitur të pandehurës A.B , citon;” *kur unë ja kam shitur telefonin e kam njohur se ka qenë rast i freskët dhe 100% është e akuzua në sallë A.B* ” dhe gjykata e shkallës së parë, këtë provë e konsideron si të vetme dhe të pambështetur edhe në provat tjera prandaj nuk ia fal besimin e plotë, edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj Gjykate ky pretendim nuk është i bazuar, ngase si me të drejtë gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj, fq.23, ka dhënë arsyet të qarta në kuptim të nenit 262 par.1 të KPP-së, se gjykata nuk shpall të pandehurit fajtor duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo prove, për të cilën qëndrim ligjor pajtohet në tërësi edhe kjo Gjykatë, e në anën tjetër vetëm fakti i shitjes së këtij telefoni të akuzuarës nuk është se vërteton një gjendjen faktike tjetër nga ajo që ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë,

respektivisht përtej dyshimit të bazuar mirë për veprimet për të cilat e ngarkon me aktakuzë këtu të akuzuarën, si pretendon prokuroria në ankesë.

Sa i përket pretendimeve tjera të prokurorisë në ankesë përkitazi me atë se duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje juridiko-penale, dëshmitarët e dëgjuar në gjykatë kanë pasur dozë pasigurie, dhe për shkak të kujtesës së tyre prandaj gjykata është dashur ti ketë parasysh dëshmitë e tyre të dhënë në fazat e hershme të kësaj procedure kur kujtesa e tyre ishte më e qartë dhe më e freskët, ndërsa në anën tjetër vet i akuzuari A.A gjatë seancës për caktimin e masës së paraburgimit është deklaruar “e kundërshtoj kërkesën e PSRK për caktimin e paraburgimit, nuk e kam kryer veprën penale, e pranon se një motor me ngjyrë të kuqe nuk e di se çfarë marke e ka ble nga një person të cilin nuk e njoh me atë rast me mua ka qenë tani i ndjeri A.D dhe E.H , kjo Gjykatë vlerëson se janë pretendimet e përgjithësuara dhe si të tilla të pambështetura në provat të administruara në këtë çështje penale. Vet fakti i pohimit i të pandehurit A.A , gjatë asaj faze të procedurës penale, për blerje të një motori të kuq, por pa ndonjë specifik tjetër të përshkruar, nuk është se vërteton pretendimin ankimor se bëhet fjalë për të njëjtin motoçikletë të gjetur në vendin e ngjarjes, ngase ashtu si edhe janë dhënë arsyet në aktgjykimin e ankimuar nga gjykata e shkallës së parë, fq.21, rrjedh se nuk është provuar se të pandehurit janë personat të cilin kishin blerë motoçikletën si në përshkrim faktik të akuzës nga dëshmitari H.R , motoçiklet e cila ishte gjetur e djegur larg vendit të ngjarjes të ditës kritike, andaj për një gjendje tjetër faktike të pretenduar nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar, është pretendim i pabazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara nga të cilat provat gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim të drejtë se nuk është provuar se të pandehurit, në bashkëkryerje, të kenë kryer veprën penale për të cilën janë ngarkuar me aktakuzës të PSRK-së.

Gjykata e Apelit e gjen të pabazuar pretendimin ankimor të prokurorisë se me dëshminë e dëshmitarit H.R , lidhur me motoçikletën e shitur nga ana e tij rezulton qartë se bëhet fjalë për të njëjtën mjet të djegur pas kryerjes së veprës penale, ngase gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj, fq.19, 20, 21, ka bërë analizimin dhe vlerësimin e dëshmisë së këtij dëshmitari të dhënë si në polici, prokurori dhe në shqyrtim gjyqësor, nga e cila dëshmi gjykata ka ardhur në përfundim se prokuroria nuk kishte provuar se ishin pikërisht të pandehurit A.A dhe E.H, personat të cilët e kanë blerë këtë motoçikletë-mjetë ky i djegur pas kryerjes së veprës penale nga ky dëshmitar, si pretendon prokuroria me ankesë, ngase pas shpalljes të procesverbalit të identifikimit të personave të datës 26.08.2016 i bërë nga H.R , si provë e papranueshme ngase ishte marrë në kundërshtim me dispozitat e nenit 120 dhe 126 par.3 të KPPRK-së, në shqyrtimin gjyqësor e në pyetjen e gjykatës, pasi ishte kthyer nga salla dhe i ka shikuar të pandehurit, kishte deklaruar se

nuk jam i sigurve se ndonjëri prej tyre kanë qenë në momentin kur ia kam shitur motorin gjë që në situatë të këtillë nuk është dëshmuar nga ky dëshmitar se motoçikleta e djegur e gjetur pas kryerës së sulmit, si pretendon prokuroria të përshkruar në dispozitiv të akuzës, t'ju ketë shitur këtu të akuzuarve në këtë çështje penale.

Sa i përket pretendimit ankimor në raport me vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë se emaili i dërguar me datë 05.08.2016, nuk ka mund të dërgohet nga të pandehurit A.B dhe F.K sepse ky email i krijuar një javë më herët është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm, se telefoni i blerë ishte telefon i vjetër dhe emaillet e hapura kanë qenë të përdorshme, kjo Gjykata e gjen të pabazuar këtë pretendim ngase gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar fq.24,25, përkitazi me këtë provë ka dhënë arsyet të qarta dhe konkrete duke ardhur në përfundim se logjikisht dhe faktikisht nuk ka mundësi që me datë 29.07.2016 të pandehurit në telefonin e tipit samsung të kenë krijuar llogarinë [rugovasi@gmail.com](mailto:rugovasi@gmail.com), e pastaj e pandehura ta ketë blerë po këtë telefon me datë 05.08.2016 përkatësisht 7 ditë më vonë nga dëshmitari N.M , e që lidhur me këtë fakt nuk ka provat tjetër që i implikon të pandehurit për dërgimin e këtij email me përmbajtje kërcënuese me qëllim të frikësimit, pasi që as nuk është gjetur telefoni tek këta persona por nuk ka as edhe një raport nga instituti i forenzikës që përmes ADN-ës të orientojnë gjykatën tek të pandehurit në fjalë, mirëpo edhe përkundër kësaj prokuroria këtë pretendim nuk e bazon në provë konkrete që kishte për tu argumentuar pretendimin se telefoni ishte i vjetër dhe emaillet e hapura kanë qenë të përdorshme.

Gjykata e Apelit gjen se ankesa e prokurorisë së shteti është e pabazuar ndërsa gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike nga e cila gjendje e fakteve ka ardhur në përfundim se nuk është provuar se të akuzuarit janë bashkryerit e veprës penale për çka i ka liruar nga akuza në kuptim të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së, për të cilën përfundim pajtohet edhe kjo Gjykatë si të drejtë dhe ligjor. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar përkitazi me këto pretendimet e ngritura dhe të apostrofuara nga prokuroria ka dhënë arsyet e qarta dhe të mjaftueshme nga të cilat ka ardhur në përfundim të drejtës se nga këto prova të administruara në shqyrtim gjyqësor nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Gjykata e Apelit rikujton se në kapitullin e parimeve themelore të kodit të procedurës penale në nenin 7 par.1 të KPPK-së në mënyrë decisive përcakton që; “ gjykata, prokurori i shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurë penale **detyrohen** që saktësisht dhe tërësisht t'i



*vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm.*” Në këtë kontekst kjo Gjykatë vëren se pretendimi i prokurorisë në ankesë përkitazi me gjendjen faktike e ndërlidh duke theksuar që me rastin konkret provat materiale dhe dëshmitë e dëshmitarëve kanë ndërlidhje të qartë dhe me shumë prova *rrethanore* të cilat gjykata as që i ka përmendur, mirëpo, se cilat në fakt janë këto provat rrethanore as prokuroria në ankesë këtë nuk e përmend e të cilat kishin për të vërtetuar pretendimin ankimor me qëllim që gjykata të mund t’i vlerësoj në kuptim të nenit 394 të KPPK-së.

Për vërtetimin e gjendjes së fakteve gjykata e shkallës së parë, në shqyrtimet gjyqësor ka administruar provat materiale dhe ato personale. Nga provat personale ka dëgjuar dëshmitarët E.M , H.R , J.Sh , K.V , M.K , N.M , R.J , R.Z, S.I , S.R , V.H dhe F.C , si dhe ka proceduar këto prova materiale duke bërë leximin e raporteve mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes të datës 05.08.2016 të cilave raporte i janë bashkangjitur lista e dëshmive si dhe foto albumet nga vendi i ngjarjes, Përgjigja e Kompanisë Google e datës 05.08.2016, Raporti informuesi DKT-së i datës 07.08./2016, Regjistrimi i thirrjeve telefonike, përmbajtja e sms-ve, transkriptet ligjore, urdhër për kontrollin i lëshuar nga Gjykata më datë 29.02.2016, raportet njoftuese të bastisjeve (7 raporte) të dt.30.08.2016, raportet e bastisjes me foto për të pandehurit: E.H të dt.31.08.2016, procesverbali mbi identifikimin e personave A.B të datës 30 dhe 31.08.2016, A.A të datës 01.09.2016 për të ndjerin A.D të datës 01.09.2016 dhe 06.09.2016 lidhur me veturë, raporti i bastisjes P.A dhe F.K i datës 31.08.2016, raportet e policëve të datës 05.08.2016 dhe kërkesat e policëve të datës 06.08.2016, 07,08,2016 dhe 08.08.2016, incizimet e nxjerra nga kamerat e sigurisë të rrugëve të Prishtinës, incizimet nga kamerat e institucioneve tjera si dhe incizimet tjera nga kamerat private, për të gjitha këto ekzistojnë urdhëresat e lëshuara nga prokuroria, raporti pas shpërthimit nga njësia IED (njësia e policisë për trajtimin e mjeteve të improvizuara eksplozive dhe ushtarake), raportet e ekspertimit të ADN-së, të daktiloskopisë, armëve të zjarrit, pajisjeve elektronike të datave 05.08.2016, 05.09.2016, 09.09.2016, 01.12.2016 dhe 12.12.2016, nga të cilat kanë vërtetuar disa rrethanat jokontestuese dhe atë se me datë 04.08.2016 rreth orës 23:05 min me raketahedhës dore RPG është kryer sulm ndaj kuvendit të R. të Kosovës, pastaj çështje se përmes portalit “merr-jep”, kryesit e veprës penale të ketë rënë në kontakt me shitësin e motoçikletës, dëshmitarin H.R , i cili me dt.17.07.2016 rreth orës 18:30 min-19:00 ju ka shitur motoçikletën dhe se e njëjta motoçikletë është përdorur nga kryesit për të lëvizur ditën kritike gjatë kryerjes së sulmit, si dhe faktin se përmes telefonit të markës “samsung” ngjyrë e zezë të tipi “galaxy mini” me numër të IMEI-3585240410187, përmes llogarisë [rugovasi12@gmail.com](mailto:rugovasi12@gmail.com), është dërguar një email me tekst kërcënues duke pasur për qëllim që

organet e R.të Kosovës gjegjësisht Kuvendin të detyroj të mos ratifikoj marrëveshjen mbi Demarkacionin dhe me këtë rast të shkaktojnë frikësimin serioz të popullsisë dhe shkaktimin e ndjenjës së pasigurisë të qytetarëve të R. të Kosovës.

Mirëpo, në anën tjetër nga deklarimet e dëshmitarëve, dhe atë të H.R , cili ndër të tjera, në shqyrtim gjyqësor është përgjigjur “se nuk mund të them, nuk jam i sigurt se ndonjëri prej tyre kanë qenë në momentin kur ia kam shitur motorin. Se sikur të isha i sigurt me siguri se do t’iu kisha thanë”, pastaj shpalljen si provë të papranueshme të procesverbalit të identifikimit të personave i datës 26.08.2016 nga ky dëshmitarë, H.R , dëshminë e dëshmitarit E.M i cili kishte deklaruar se personat që i ka pa në motor nëse do ti dalin përpara mbi bazën e madhësisë dhe formave pak a shumë kishte mujt me i identifikua por, personat që janë në sallë i njeh vetëm si figura, është fjala për të akuzuarit A., F, E dhe A, por se këta nuk janë ata që i ka pa në motor. Dëshmitarët J.Sh dhe V.H , kishin dëshmuar se i pandehuri A.A ditën kritike kur kishte ndodhur edhe shpërthimi i njëjti ka qenë në shoqërinë e këtyre dy dëshmitarëve. Dëshmitarja F.C , kishte deklaruar, ndër të tjera se, natën kritike, në momentin e shpërthimit, i pandehuri E.H kishte qenë në shoqërinë e kësaj dëshmitare në një banesë në lagjen Iliria, e cila gjykatës i kishte paraqitur edhe disa sms të shkëmbyera gjatë ditës kritike, dt.04.08.16, para se të takoheshin për në banesë. Dëshmitari R.Z, taksist, në shqyrtim gjyqësor, ndër të tjera kishte deklaruar se “ nuk mund të përcaktohem për asnjërin që së paku i përngjan asaj vajzës të cilën e kam vozitur”, është fjala për ditën kritike, e që gjykata në raport me këtë dëshmitar kishte vlerësuar dhe çështjen e procesverbalit të identifikimit të personave, për të cilin gjykata duke vlerësuar se si ishte përcaktuar dëshmitari për foton nga e cila ishte identifikuar të pandehurën A, në detajin e syzave që i ka mbajtur në kokë, ngjashëm me personin të cilin dëshmitari edhe e ka vozitur, në raport me këtë provë, gjykata kishte vlerësuar këtë edhe në raport me dëshminë e tij i cili ishte shprehur se nuk është i sigurt për përzgjedhjen e presonit në foto, e që thjesht e ka bërë nga syzet e diellit në flokë, pastaj se edhe nga provat-raportet e marra nga vendi i ngjarjes, e të cilat pas ekzaminimit në institucionet profesionale për krahasim, e të administrua në shqyrtim gjyqësor e që janë: raporti i forenzikës mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes të dt. 05.08.2016; ekspertizat e ADN-së, Grafologjisë, Daktiloskopisë e raportit të FBI-së; raporti i ekspertimit për Serologji dhe ADN i Agjencisë së Kosovës për Forenzikës, me nr. referues të hetimeve 2016-AB-2494 i dt. 30.09.2016; raporti i ekspertimit për eksploziv, grimca të barutit dhe zjarr vënie, me nr. ref. 2016-AB-2494 të dt.14.09.2016; raporti i ekspertimit i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, me nr. referues 2016-AB2494 të dt.01.12.2016; Raporti i ekspertimit i Agjencisë Kosovare për Forenzikë - Laboratori për Serologji dhe ADN i dt. 18.08.2016; Raporti i Ekspertizës i dt.

15.08.2016, i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë; raporti i vendit të ngjarjes; Raporti i Ekspertimit i dt.01.11.2016, i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë; raporti i ekspertizës i datës 13.12.2016, i Drejtorisë së Teknikës Kriminalistike-Sektori për fotografi, video analizë dhe ekzaminim të IT-së, Njësia për ekzaminimin e pajisjeve të IT-së; raporti njoftues i dt. 11.08.2016 i Drejtorisë së Teknikës Kriminalistike-Sektori për Fotografim -video analizë dhe Ekzaminime të IT-së; raporti i ekspertimit i dt.29.12.2016, i përpiluar nga Agjencioni i Kosovës për Forenzikë; raporti i ekzaminimit të Departamentit të Drejtësisë së SHBA-Byrosë Federale të Hetimeve, Nr. dosjes KS-17-021 i datës 07.04.2017 lidhur me qartësimin e imazhe të realizuara nga incizimet e kamerave, nuk kanë rezultuar me rezultat që në çfarëdo forme apo mënyre, që nga këto provat-mjete që janë përdorë nga kryesit për të kryer veprën penale të sulmit në Kuvendin e R të Kosovës në ditën kritike, e të përshkruar në dispozitiv të akuzës dhe aktgjykimit të ankimuar, të jenë të ndërlidhur apo të kenë lidhshmëri kauzale me të akuzuarit në këtë çështje penale andaj, duke marrë parasysh vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendje së fakteve nga gjykata e shkallës së parë edhe kjo Gjykatë pajtohet me përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se me provat të propozuara për administrim përgjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit janë bashkëkryerës të veprës penale terroriste nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 135 par.1 lidhur me 1.7 të KPRK e lidhur me nenin 31 të KPK, për të cilën janë ngarkuar me akuzë nga prokuroria, andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë, bazuar dhe në prezumimin e pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo, për të akuzuarit në kuptim të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, ka marrë aktgjykim me të cilin ka liruar të akuzuarit nga akuzua meqë nuk është provuar se të akuzuarit në bashkëkryerje të kenë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimor se në këtë çështje penale, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike është shkel edhe ligji penal nga gjykata e shkallës së parë, kjo për faktin se, meqenëse në këtë çështje penale gjendja e fakteve është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë rezulton se nuk ka as shkelje të ligjit penal pasi që, ashtu si me të drejtë dhe në mënyrë të qartë gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar ka dhënë arsyet për faktet vendimtare në këtë çështje penale, dhe se në rastin konkretë nuk është vërtetuar me provat e administruara përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar nuk rezulton as pretendimi ankimor që të jetë i bazuar në këtë drejtim.

Andaj, duke pasur parasysh gjendjen e fakteve të vërtetuar në shqyrtimin gjyqësor dhe ky kolegji penal është bindur se gjykata e shkallës së parë arriti në përfundimin e drejtë, se nga provat e administruara nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar se të akuzuarit në bashkëkryerje të

kenë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar, andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë në kuptim të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, të akuzuarit i ka liruar nga akuzua meqenëse nuk është provuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Nga arsyet e sipër cekura dhe në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**DEPARTAMENTI SPECIAL**  
**APS.nr.16/2023, datë: 31.10.2023**

**Bashkëpunëtori Profesional,**

**Anëtarët e kolegjit,**

**Kryetar i kolegjit,**

---

**Endrit Ajeti**

---

**Vaton Durguti**

---

**Kreshnik Radoniqi**

---

**Bashkim Hyseni**